



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



N.SH. "Media 7 Kosova"
Enkelejda KUMARAKU
Pronar
Radio K
Rr/Dardania, Kompleksi Model Sllovenia, H2, NrB60
Fushë Kosovë

Ref: 1704/312/LIC/ni

VENDIM

*për ndryshimin e lokacionit të sistemit të transmetimit dhe emrit të Radio K– me seli në
Fushë Kosovë*

Fakte

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuele, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Radio K është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audio me mbulim lokal, i cili është i licencuar për të transmetuar radio programe në shërbim të qytetarëve të Komunës e Fushë Kosovës.
3. Më 30 mars 2017, Radio K ka parashtruar kërkesën për ndryshimin e vendndodhjes së lokacionit të sistemit të transmetimit nga pika e transmetimit në qytetin e Fushë Kosovës, për ku janë të licencuar për të transmetuar, për të kaluar me transmetim në pikën e transmetimit në lokacionin te Pishat në Sllatinës.
4. Arsytimi i pronarit të Radio K, për ndryshimin e lokacionit të sistemit të transmetimit, mbështetet në anëkesat e banorëve të lagjës ku është vendosur transmetuesi, për arsye se ata janë kundër që transmetuesi të vazhdoj të jetë i vendosur në zonën e tyre të banimit për shkak të mundësisë së rrezatimit.
5. Më datë 31 mars 2017, Departamenti i Menaxhimit Frekuencor (DMF) i KPM-së ka realizuar matjet teknike në piken e propozuar për vendosjen e transmetuesit të Radio K, në lokacionin te Pishat në Sllatinë, në koordinatat $N42^{\circ}36'31''$ dhe $E 21^{\circ}01'19''$, me lartësi mbidetare 620 m, për të vlerësuar gjendjen faktike në terren si dhe ka bërë

analizen e rezultateve hulumt me ndryshimin e lokacionit të transmetimit, sipas kërkesës së Radio K.

6. Gjithashtu, me datën 5 prill 2017, perfaqësuesi i Radio K, ka dorëzuar në zyrën e KPM-së edhe një kërkesë me anë të së cilës ka kërkuar ndryshimin e emrit nga Radio K në Radio 7 Kosova.

Arsyetim

7. Neni 16 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së, paragrafi 1 thekson se: *Përveç dispozitave për bartjen e pronësisë të specifikuar në Nenin 15, i Licencuari paraprakisht parashtron kërkesë me shkrim për ndryshimet e specifikuar në paragrafet e Pjesës 2 të Licencës së KPM-së si dhe në Pjesët 3 dhe 4, përfshirë frekuencën, Fuqinë e Rrezatuar Efektive dhe vendndodhjen e transmetuesit ose antenës, formatin e programit dhe zonën e mbulimit. Ndryshime të tilla mund të bëhen vetëm pasi të jenë miratuar nga ana e KPM-së.*
8. Gjithashtu, neni 16 i Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së, paragrafi 2 thekson se: *“Me anë të dërgimit të një njoftimi me shkrim të të Licencuarit, KPM-ja mund të ndryshojë kushtet e Pjesës 2, Standardet Teknike, Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës së transmetimit me një procedurë të përcaktuar në pajtueshmëri me Ligjin e KPM-së. KPM-ja do të sigurohet që këto ndryshime janë të domosdoshme për të garantuar një përdorim më të rregullt të spektrit frekuencor”.*
9. Në bazë të vlerësimit të rezultateve të DMF-së, Zyra Ekzekutive konstaton se, ndryshimi i lokacionit të transmetimit sipas kërkesës së Radio K, për të zhvendosur sistemin e transmetimit nga pika e transmetimit nga qyteti i Fushë Kosovës, për ku janë të licencuar për të transmetuar sipas licencës, *me lartësi lartësi mbidetare prej 541 m, dhe për të zhvendosur transmetuesin në pikën e transmetimit, në lokacionin te Pishat në Sllatinë, në koordinatat N42°36'31" dhe E 21°01'19", me lartësi mbidetare 620 m dhe me një distancë ajrore prej 7 km në vijë të drejtë nga lokacioni i licencuar, diferenca e lartësisë mbidetare në mes të pikave është e vogël, ndryshim është përbrenda komunës së Fushë Kosovës dhe Radio K nga pika e propozuar për transmetim, përsëri mbulon zonën për të cilën është licencuar.*
1. Në pajtim me nenin 16, paragrafi 1 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, Komisioni konstaton se, kërkesa për ndryshimin e lokacionit të sistemit të transmetimit të Radio K është e bazuar dhe në pajtueshmëri me Kushtet dhe Termet e Licencës KPM-së, dhe si e tillë i plotëson kushtet për miratim nga ana Komisionit.
2. Poashtu, Komisioni konstaton se, emri i propozuar për ndryshim “Radio 7 Kosova”, nuk është i ngjajshëm me asnjë nga emrat e të licencuarve të KPM-së dhe se gjatë përdorimit të tij për identifikim nuk do të shkaktojë konfuzion tek dëgjuesit, prandaj, edhe kërkesa për ndryshimin e emrit të Radio K në “Radio 7 Kosova” i plotëson kushtet për miratim.

Vendim


10. Komisioni në takimin e mbajtur më datën 14 prill 2017 merr vendim për aprovimin e kërkesës për ndryshimin e lokacionit të transmetuesit të Radio K nga pika e

transmetimin në qytetin e Prishtinës, për të cilin është licencuar për të transmetuar sipas licencës, dhe kalimin në pikën e transmetimit në lokacionin të Pishat në Sllatinë, sipas koordinatave të lartpërmendura.

11. Komisioni, gjithashtu, merr vendim për ndryshimin e emrit të Radio K në Radio 7 Kosova, sipas kërkesës.

Lëshimi i Vendimit

12. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit.



Adnan MEROVCI

Kryetar

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



14.04.2017
datë

312

Lloji i dërgesës _____
Vrsta poşiljke _____

Vlera e cekur - Shuma e dërguar _____
Oznaçona vrednost - poslani iznos _____

nën numër _____
pod br. _____

për _____
za _____

ENKELEJDA KUNARAKU - RANBO "K"
R/DARDANIA, KONPEKSI MOEL SLOVENIJA H2 NR 60

(Vendi)
(Mesto) FUSHË KOSOVË

Poshtë i nënshkruari deklaron që dërgesa e cekur (shuma e dërguar) është dorëzuar në rregull (paguar me datë) 06-06-17

Dole potpisani izjavljuje da je pomenuta pošiljka (poslani iznos) predana uredno (placena dana)

Nënshkrimi i marrësit
Potpis primaoca



Vula e postës së vendit
Peçat pošte



Nënshkrimi i nënpunësit
të postës së vendit
Potpis radnika pošte

